REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KËSHILLI I BASHKISË

Nr5734 Prot Maliq, më 28.09.2026

VENDIM

Nr 118, datë 28.09.2026

PËR
"Disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Këshillit të Bashkisë Maliq nr. 2, datë 08.01.2026 "Rishqyrtim i Vendimit të Këshillit të Bashkisë Maliq nr. 147, datë 24.12.2025 "Për miratimin e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të Administratës të Bashkisë dhe strukturave të tjera të varësisë", i ndryshuar"

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar, neni 8, pika 2, neni 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", neni 29/1, shkronja "a", neni 54, shkronja "ç", ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 328, datë 31.05.2023 *"Për klasifikimin e e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendor, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore*", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 326, datë 31.05.2023 *"Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të Administratës Publike"*, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Bashkisë Maliq nr. 2, datë 08.01.2026 "*Rishqyrtim i Vendimit të Këshillit të Bashkisë Maliq nr. 147, datë 24.12.2025 "Për miratimin e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të Administratës të Bashkisë dhe strukturave të tjera të varësisë"*, i ndryshuar, këshilli i bashkisë,

VENDOSI :

I. Të miratojë disa shtesa dhe ndryshime në strukturën organizative të Bashkisë Maliq si më poshtë:

1- Në strukturën e Administratës së Bashkisë Maliq (qëndër), në lidhja nr. 1 të bëhen disa ndryshime si më poshtë:

- Në "*Drejtorinë e të Ardhurave*", të ndryshohet paga për pozicionin e punës "***Përgjegjës Sektori***" në Sektorin e Regjistrim, Vlerësimit, Klasa III-3, me pagë grupi nga 10-14.000, paga për pozicion në masën **85,000** (*tetëdhjetë e pesë mijë*) lekë dhe shtesë 0.6-1% për vjetërsi në punë;

- Në "*Drejtorinë e Pronave Publike dhe Aseteve*", të ndryshohet paga për pozicionin e punës "***Specialist Strehimi***" në Sektorin e Strehimit, me nr. rendor 8 në këtë drejtori, Klasa IV-3, me pagë grupi nga 10-14.000, paga për pozicion në masën **55,000** (*pesëdhjetë e pesë mijë*) lekë dhe shtesë 0.6-1% për vjetërsi në punë.

2- Në strukturën e "*Arsimi Parashkollor + Mbështetës*", të bëhet një shtesë si më poshtë:

- Në strukturën "*Punonjës mbështetës Arsimi 9-vjeçar + Parashkollor*", të shtohet pozicioni i punës "***Sekretare***", Shkolla Zvezdë + Shëngjergj, Klasa VII, paga për pozicion **53,600** (*pesëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind*) lekë dhe shtesë 1% për vjetërsi në punë.

II. Efektet financiare fillojnë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi dhe përballohen nga buxheti i miratuar i Bashkisë Maliq për vitin 2026.

III. Për nxjerrjen e urdhrit për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

IV. Ky vendim hyn në fuqi sipas percaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar.

Miratuar me 20 vota
Vota Pro 20
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur me datë 28.09.2026

KRYETARI I KËSHILLIT
Ornildi DEMOLLARI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ